



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 117, datë 30.07.2018**

**PËR**

**NDALIMIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË AGJENTIT NË SIGURIME**  
**ZJ. TONE DACI**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 199, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E:**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në mbështetje të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, nenit 19, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, duke marrë shkas nga kërkesa e shoqërisë “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a. nëpërmjet e-mailit të datës 25.05.2018 për ndryshimin e datave të një police sigurimi TPL, të deklaruar nga vetë ajo si të shitur jashtë sistemi, kreu një inspektim në vend në shoqërinë “Sigal” sh.a. në datë 01.06.2018, për verifikimin në vend të rastit në fjalë.

Nga inspektimi është konstatuar se sigurimi TPL, me nr. serial 002550100 është shitur jashtë sistemit të regjistrit online të shitjes, nga agjentja në sigurime Zj. Tone Daci. Kjo policë ka vlefshmëri 18.07.2017-17.07.2018.

Për këtë rast sqarojmë se mjeti i pajisur me këtë policë sigurimi është përfshirë në aksident më datë 24.04.2018, datë e cila në sistemin online të raportimit, nuk përkon me mbulimin në sigurim të këtij mjeti (në sistem është raportuar më datë 17.05.2018).

Pra agjentja në sigurime Zj. Tone Daci ka shitur një policë sigurimi TPL, në kundërshtim me nenin 38, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Bazuar në pikën 5, të nenit 199, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të ndalohet ushtrimi i veprimtarisë së agjentit Zj. Tone Daci.

2. Ngarkohet Zyra e Licencimit pranë Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për çregjistrimin nga regjistri i ndërmjetësve, mbylljen e kodit të shitjes dhe njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin KOÇI**